



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI**

UDHËZIM

Nr. 1, datë 26.02.2021

PËR

**“NJË SHITESË DHE NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 4038, DATË 04.09.2015 “PËR
PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE UNIVERSALE POSTARE QË OFROHEN PA PAGESË PËR
PERSONAT E VERBËR DHE Pjesërisht të verbër”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 4 të nenit 28 të Ligjit Nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”,

U D H Ë Z O J:

Në udhëzimin nr. 4038, datë 04.09.2015 “Për përcaktimin e shërbimeve universale postare që ofrohen pa pagesë për personat e verbër dhe pjesërisht të verbër”, bëhet një shtesë dhe një ndryshim si më poshtë:

1. Kudo në përmbajtje, emërtimi: “Shoqata/ën e të Verbërve në Shqipëri” të zëvendësohet me fjalët “...Shoqatat apo organizatat e regjistruara për të verbërit në Shqipëri...”.
2. Pas pikës 9, të shtohet pika 9/1, me këtë përmbajtje:
“9/1. Përfaqësuesi i shoqatës apo organizatës për të verbërit, përfituese e shërbimeve universale postare pa pagesë sipas këtij udhëzimi, paraqet në sportelin postar kopje të dokumentit të regjistrimit në gjykatë.”
3. Ngarkohet Ofruesi i shërbimit universal postar dhe AKEP për zbatimin e këtij Udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Belinda Balluku